



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.147

23 shtator

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.5894 datë 17.9.2008	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 7263
Dekret nr.5983 datë 17.9.2008	Për lejim të shtetësisë shqiptare 7263
Vendim i KM nr.1232, datë 18.6.2008	Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga objektet shtetërore 7264
Vendim i KM nr.1239, datë 10.9.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Memaliaj fshat, të qarkut të Gjirokastrës 7266
Vendim i KM nr.1240, datë 10.9.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Pogradec, të qarkut të Korçës 7267
Vendim i KM nr.1241, datë 10.9.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.1046, datë 16.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Tipografia Ushtarake sh.a., Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë, Tiranë, të disa reparteve dhe të një trualli funksional ”... 7268
Vendim i KM nr.1242, datë 10.9.2008	Për një shtesë në vendimin nr.191, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e oponencës teknike shtetërore për projektet e ndërtimit të hidrocentraleve, me koncesion”, të ndryshuar 7271

Vendim i KM nr.1243, datë 10.9.2008	Për miratimin e rregullores për organizimin e kohës së punës të personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit	7271
Vendim i KM nr.1244, datë 10.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, në vitin akademik 2008-2009	7272
Vendim i KM nr.1245, datë 10.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në vitin akademik 2008-2009	7273
Vendim i KM nr.1246, datë 10.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë, pranë Universitetit të Tiranës, në vitin akademik 2008-2009	7274
Vendim i KM nr.1247, datë 10.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë, të gjuhës angleze dhe të infermierisë së përgjithshme, si filiale të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe të Fakultetit të Infermierisë, të Universitetit të Tiranës, në qytetet e Kukësit dhe Sarandës, në vitin akademik 2008-2009, si dhe për përcaktimin e kuotave të pranimi dhe të tarifës së shkollimit, për këto programe	7274
Vendim i KM nr.1248, datë 10.9.2008	Për shpalljen e javës së ujit në Shqipëri	7275
Vendim i KM nr.1249, datë 10.9.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i një kanali për vendosjen e një tombinoje, përgjatë superstradës Lezhë-Shkodër, seksioni Piraj-Vau i Dejës	7276
Vendim i KM nr.1250, datë 10.9.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i objektit “Lidhja e qytetit Berat-Përmet”	7277
Vendim i KM nr.1251, datë 10.9.2008	Për përcaktimin e numrit referues të të punësuarve, për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në disa veprimtari kryesore, për tatimpaguesit e regjistruar në biznesin e vogël	7278
Vendim i KM nr.1252, datë 10.9.2008	Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave	7280
Vendim i KM nr.1253, datë 2.7.2008	Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të vlerësimit për dëmshpërblimin e përfutur nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist	7290
Vendim i KM nr.1264, datë 17.9.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Fushë-Krujë, të qarkut të Durrësit.....	7294
Vendim i KM nr.1265, datë 17.9.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Zagorie, të qarkut të Gjirokastrës.....	7295

DEKRET
Nr.5894, datë 17.9.2008

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 19 dhe 24 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare” i ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- 1.Arben Kapllan Resulbegu
- 2.Majlinda Iriat Xhudoviq (Bylykbashi)
- 3.Dejan Sllovenko Xhudoviq
- 4.Joniada Sllovenko Xhudoviq
- 5.Idajete Xhevit Diamanti (Çaushi)
- 6.Fatime Ismail Krasniqi
- 7.Fatmir Mus Krasniqi
- 8.Jetmir Mus Krasniqi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.5983, datë 17.9.2008

PËR LEJIM TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1.Herion Jovan Novaku | 6.Ana Vehip Aliko |
| 2.Valbona Vasillaq Novaku (Bukuvali) | 7.Jurgen Naresim Pashkaj |
| 3.Herva Herion Novaku | 8.Aneta Naresim Pashkaj |
| 4.Bashkim Shaqir Alla | 9.Merita Kozma Thorbech (Rrapushi) |
| 5.Naresim Rexhep Pashkaj | 10.Orjola Kristaq Bërxfholi |
| 11.Migena Xhevair Xhaferri (Krasniqi) | 33.Arjan Jusuf Mullahi |
| 12.Afërdita Sul Lushaj | 34.Skënder Yzeir Bala |
| 13.Artan Mustafa Kuçi | 35.Nezajet Qenan Hida (Bakiu) |
| 14.Ermira Hazir Müller (Malaj) | 36.Manjola Safet Kule |

15.Adrian Gori Bega
16.Gëzim Spiro Dhimërtika
17.Irma Dilaver Plass (Sulçe)
18.Liljana Shaban Fassançht (Pasha)
19.Daniel Elton Caushmenaj
20.Dea Elton Caushmenaj
21.Lefter Robert Adhamidhi
22.Burbuqe File Dosti
23.Jaqueline Sulo Dosti
24.Artan Zel Lala
25.Angjelina Millorad Verbica
26.Denada Enver Kufner (Bllaca)
27.Sami Haxhi Disha
28.Irma Ndoc Ljoki (Barbullushi)
29.Luljeta Vangjel Kristo (Zhara)
30.Zamir Bajram Krasniqi
31.Albert Mark Bardhoci
32.Ilir Sotiraq Cigare

37.Dorina Mark Curri
38.Ilir Hasan Dumi
39.Gentjana Refik Dumi (Dervishi)
40.Dea-Sara Ilir Dumi
41.Endri Ilir Dumi
42.Enkelejda Myqerem Tafaj
43.Elira Masar Mino (Bekteshi)
44.Kevin Andreas Mino
45.Anuel Andreas Mino
46.Albana Jahja Verkaj (Lazaj)
47.Clay Arben Verkaj
48.Uesli Arben Verkaj
49.Aida Guri Qiraxhi
50.Adriatik Nexhmedin Agalliu
51.Juxhina Lek Përgjini

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.1232, datë 18.6.2008

PËR KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT FIZIK NGA OBJEKTET SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në fondin e kompensimit fizik dhe vënien në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të 29 objekteve shtetërore, sipas lidhjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pasi bën verifikimin përfundimtar të pronësisë së truallit për fondin e mësipërm, e përdor atë për kompensimin e pronarëve, sipas kritereve të përcaktuara në ligj.
3. Pas verifikimit përfundimtar, të bërë nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pronat, të cilat rezultojnë me njohje apo kthim pronësie, zbriten nga fondi i mësipërm.
4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**DOSJET E KTHYERA NGA DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE SHITJES SË PRONAVE
PUBLIKE QË DO TË PËRFSHIHEN NË FONDIN E KOMPENSIMIT FIZIK**

Nr.	Emërtimi i objektit	Miratim privatizimi	Institucioni/ndërmarrja nga varet	Vendodhja
1	Ndërtesa zyra+WC	nr.169, datë 28.5.1998	Ndërmarrja Rruga Ura	Korçë
2	Uzina Ni-Co	nr.167, datë 25.5.1998	Uzina Ni-Co	Elbasan
3	Magazinë nr.2 Trebinjë	nr.285, datë 28.8.1998	Nd.Grumb-Pogradec	Pogradec
4	Tunel në formë U	nr.4341/1, datë 14.10.1998	Drejt.Ujërave	Çorovodë, Skrapar
5	Depo materiali (autopark)	nr.1469, datë 3.3.1999	Rep.Usht. 5012	Gjinat, Elbasan
6	Depo ushqimore nr.3	nr.5176/2, datë 24.12.1998	Rep.Usht.5013	Terpan, Berat
7	Mencë e bufe	nr.5176/2, datë 24.12.1998	Nd.Qymyrgurit Pograd	Pogradec
8	Fjetore cervenake	nr.1469, datë 3.3.1999	Rep.Usht.5013	Terpan, Berat
9	Depo ushqimore nr.4	nr.1469, datë 3.3.1999	Rep.Usht.5013	Terpan, Berat
10	Depo veshmbathje nr.5	nr.1469, datë 3.3.1999	Rep.Usht.5013	Terpan, Berat
11	Depo veshmbathje nr.6	nr.1469, datë 3.3.1999	Rep.Usht.5013	Terpan, Berat
12	Depo veshmbathje nr.7	nr.1469, datë 2.3.1999	Rep.Usht.5013	Terpan, Berat
13	Depo veshmbathje nr.8	nr.1469, datë 3.3.1999	Rep.Usht.5013	Terpan, Berat
14	Depo drithi Lozhan	nr.5661/1, datë 30.2.1998	NGP Drithi	Lozhan, Korçë
15	Depo drithi Mocan	nr.5661/1, datë 30.2.1998	NGP Drithi	Moçan, Korçë
16	Dyqan nën banesë e kromit	nr.2927, datë 5.6.1998	Enti kombëtar i banesave	Pogradec
17	Depo frigoriferi	nr.229, datë 22.7.1998	Drejtorja e bujqësisë	Ersekë
18	Truproje Terpan	nr.1469, datë 3.3.1999	Rep.Usht. 5013	Terpan, Berat
19	Depo veshmbathje nr.2	nr.1469, datë 3.3.1999	Rep.Usht.5013	Terpan, Berat
20	Magazinë nr.1 Trebinjë	nr.285, datë 28.8.1998	NGP Drithi	Pogradec
21	Thertore	nr.300, datë 28.8.1998	Bashkia	Lushnjë
22	Reparti i konventave	nr.2779, datë 2.6.1998	NPC Elbasan	Elbasan
23	Magazinë ushqimore Skrojske	nr.1319, datë 25.2.1999	Miniera Fe-Ni Prrenjas	Prrenjas
24	Depo veshmbathje nr.9	nr.1469, datë 2.3.1999	Rep.Usht.5013	Rep.Usht.5013
25	Depo materiale veshmbathje	nr.4341/1, datë 14.10.1998	Rep.Usht.5012	Gjinat, Elbasan
26	Thertore		Bashkia	Kukës
27	Peshore 20 tonë	nr.285, datë 28.8.1998	NGP Drithi	Pogradec
28	Reparit mekanik UMB Korçë	nr.2790, datë 2.6.1998	Uzina Mek. Bujqësore	Korçë
29	Pikë shpërndarje Karb. Kurbnesh	nr.1914/3, datë 19.4.2001	ARMO sh.a.	Kurbnesh

**VENDIM
Nr.1239, datë 10.9.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS
MEMALIAJ FSHAT, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës paraprase të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Memaliaj Fshat, të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprase, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Memaliaj Fshat, të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.5, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fushë-Memaliaj, të qarkut të Gjirokastrës”.

2.Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Memaliaj Fshat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Memaliaj

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14,15	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
16-24	Varrezat publike	Në pronësi
25-31,35-45,58,59,66,68,71,75,77,89-92	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
32-34,46-57,60-65,67,69,70,72-74,76,78-88,158-357	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike.).	Në pronësi
358-360	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
130-132,134-136,138,139,141-147,149-151,153,154,156,157	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
107,112, 121,122, 124,128, 129, (vetëm kanalet e treta) 133,137,140,148,152,155	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi

VENDIM

Nr.1240, datë 10.9.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
BASHKISË POGRADEÇ, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Pogradec, të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 297 (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë).

2.Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Pogradecit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Pogradec

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
106,107	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
4-5,7-12,16	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
158-170	prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
173 (vetëm ambientet e shërbimit parësor),175	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve n shërbimin parësor	Në pronësi
1-3,6,13-15,17	Prona që përdoren në fushën e sportit dhe kulturës	Në pronësi
19-90	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile	Në pronësi
91-105,110,113	Infrastrukturë (rugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
115-116	Varreza publike	Në pronësi
111	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
18	Prona që përdoren në fushën sociale	Në pronësi
114	Rrjeti i ndriçimit publik	Në pronësi
112	Transferohen vetëm ledhe mezhda, shkëmbore, gurishore, toka të pafrytshme	Në pronësi
121-125,127,138-143,149,151	Zyra të partive politike, shoqatave ose zyra të tjera që ndodhen në ndërtesën e bashkisë	Në pronësi
Z.Kadastrale 8582, pasuritë Nr.1/174,1/176,1/177,1/178,	Truall	Nuk transferohen

VENDIM
Nr.1241, datë 10.9.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1046, DATË 16.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI NGA TIPOGRAFIA USHTARAKE SH.A., SHYTPSHKRONJËS SË LETRAVE ME VLERË, TIRANË, TË DISA REPARTEVE DHE TË NJË TRUALLI FUNKSIONAL ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14, e 15, shkronja « c » të ligjit

nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Pika 1, e vendimit nr.1046, datë 16.7.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

«1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Tipografia Ushtarake, sh.a., Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë, Tiranë, të disa reparteve, me sipërfaqe 1 625 (një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) m², sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi. ».

2.Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Kufiri ekzistues
Kufiri i Ri

Objekti: Hangar
Sip: 1625m²

[illegible]

10564



VENDIM
Nr.1242, datë 18.6.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.191, DATË 22.3.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR VENDOSJEN E OPONENCËS TEKNIKE SHTETËRORE PËR
PROJEKTET E NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALEVE, ME KONCESION”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 6, 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 7, të vendimit nr.191, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

«7/1. Pagesat e grupit të ekspertëve, për periudhën 1 korrik deri më 31 dhjetor 2008, në shumën 10 758 000 (dhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet korente, zëri «Transferita të jashtme », të miratuara në buxhetin e vitit 2008, për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.».

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1243, datë 10.9.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E KOHËS SË PUNËS TË
PERSONAVE, QË KRYEJNË TRANSPORT RRUGOR, PËR ORËT E DREJTUESVE TË
MJETEVE DHE PAJISJET E REGJISTRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 224 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe të neneve 76, pika 2, e 97, pika 1, shkronja “e” të ligjit nr.7961, datë 12.7.1996 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për organizimin e kohës së punës të personave, që kryejnë transport rrugor, të lëvizshëm, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Nenet 342 e 343, pikat 2 e 3 të vendimit nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave “Rregullorja në zbatim të Kodit Rrugor”, të ndryshuar, shfuqizohen.

3. Pika 2 e vendimit nr.360, datë 25.3.1996 të Këshillit të Ministrave, “Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit në ndërmarrjet e transportit automobilistik, hekurudhor, detar dhe ajror, dhe ndërmarrjet, që mirëmbajnë dhe riparojnë mjetet e transportit”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë rregullore, shfuqizohen.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1244, datë 10.9.2008

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË
UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Pyjore, të programeve të mëposhtme të studimit, të ciklit të dytë:

a) Programi i studimit “Inxhinieri përpunim-druri”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri përpunim-druri;

b) Programi i studimit “Inxhinieri pyjore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri pyjore.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin Bujqësor të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1245, datë 10.9.2008

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, të programeve të mëposhtme të studimit, të ciklit të dytë:

a) Programi i studimit “Inxhinieri gjeologjike”, me profile:

- Gjeologji inxhinierike dhe hidrogeologji;
- Vendburimet e mineraleve të dobishme-petrologji;
- Gjeologji e vendburimeve hidrokarbure;
- Gjeoinformatikë.

Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri gjeologjike, profili gjeologji inxhinierike dhe hidrogeologji;
- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri gjeologjike, profili vendburimet e mineraleve të dobishme-petrologji;
- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri gjeologjike, profili gjeologji e vendburimeve hidrokarbure;
- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri gjeologjike, profili gjeoinformatikë.
- b) Programi i studimit “Inxhinieri e burimeve natyrore”, me profile:
 - Inxhinieri e burimeve të energjisë;
 - Përpunim mineralesh dhe mbetjesh;
 - Gjeomatikë;
 - Gjeoinxhinieri.
- Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:
 - Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinierinë e burimeve natyrore, profili inxhinieri e burimeve të energjisë;
 - Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinierinë e burimeve natyrore, profili përpunim mineralesh dhe mbetjesh;
 - Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinierinë e burimeve natyrore, profili gjeomatikë;
 - Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinierinë e burimeve natyrore, profili gjeoinxhinieri.
- c) Programi i studimit “Inxhinieri gjeofizike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri gjeofizike.
- ç) Programi i studimit “Inxhinieri e gjeomjedisit”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinierinë e gjeomjedisit.
- 2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.
- 3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.
- 4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.
- 5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTIRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.1246, datë 10.9.2008**

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, PRANË **UNIVERSITETIT TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit të Tiranës, të programeve të studimit, të ciklit të dytë, sipas fakulteteve:
 - a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:
 - i) Programi i studimit “Shkencat dhe teknologjitë ushqimore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në shkencat dhe teknologjitë ushqimore.
 - b) Në Fakultetin e Shkencave Sociale:
 - i) Programi i studimit “Psikolog shkollor/organizacional”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, profili psikolog shkollor/organizacional.

ii) Programi i studimit “Psikolog klinik i zhvillimit dhe marrëdhënieve”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, profili psikolog klinik i zhvillimit dhe marrëdhënieve.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin e Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTIRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1247, datë 10.9.2008

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, TË GJUHËS
ANGLEZE DHE TË INFERMIERISË SË PËRGJITHSHME, SI FILIALE TË FAKULTETIT
TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË FAKULTETIT TË INFERMIERISË, TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS, NË QYTETET E KUKËSIT DHE SARANDËS, NË VITIN
AKADEMIK 2008-2009, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË
TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR KËTO PROGRAME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja “b”, 26, 33, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programit të studimit, të ciklit të parë, “Gjuhë angleze”, si filial i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të Universitetit të Tiranës, në qytetet e Kukësit dhe të Sarandës, në vitin akademik 2008-2009.

Në përfundim të këtij programi studimi do të lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP, në gjuhë angleze.

2. Hapjen e programit të studimit, të ciklit të parë, “Infermieri e përgjithshme”, si filial i Fakultetit të Infermierisë, të Universitetit të Tiranës, në qytetin e Kukësit, në vitin akademik 2008-2009.

Në përfundim të këtij programi studimi do të lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP, në infermieri të përgjithshme.

3. Programet e studimit të ciklit të parë realizohen me 180 kredite dhe zgjatja normale e tyre është tri vite.

4. Numri i kuotave të pranimeve, në këto programe studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, është, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-----|
| a) Programi i studimit “Gjuhë angleze”, në filialin e Kukësit; | 25; |
| b) Programi i studimit “Gjuhë angleze”, në filialin e Sarandës; | 25; |
| c) Programi i studimit “Infermieri e përgjithshme”, në filialin e Kukësit. | 60. |

5. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që regjistrohen në vitin e parë, në këto programe studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti, i miratuar për Universitetin e Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1248, datë 10.9.2008

PËR SHPALLJEN E JAVËS SË UJIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, e 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen "Java e ujit në Shqipëri" të javës së parë të muajit nëntor të çdo viti.
2. Të gjitha institucionet shtetërore të fushës, në nivel qendror dhe vendor, si dhe shoqata e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri, veçmas ose në bashkëpunim, të programojnë, organizojnë dhe realizojnë, në këtë kuadër, brenda juridiksionit dhe mundësive të tyre financiare, infrastrukturën festive dhe veprimtari të ndryshme.
3. Ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore, të përmendura në pikën 2, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1249, datë 10.9.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I NJË KANALI PËR
VENDOSJEN E NJË TOMBINOJE, PËRGJATË SUPERSTRADËS LEZHË-SHKODËR,
SEKSIONI PIRAJ-VAU I DEJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për buxhetin e shtetit, të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i një kanali për vendosjen e një tombinoje, përgjatë superstradës Lezhë-Shkodër, seksioni Piraj-Kthesa Vau i Dejës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, me nr.pasurie 133/13, në zonën kadastrale 2 544, të shpronësohet, për sipërfaqen 414 (katërqind e katërmëdhjetë) m², tokë arë, e vlerësuar me 376 (treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë/m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 155 664 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 133 500 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 155 664 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, të përballohet nga buxheti shtesë i vitit 2008, miratuar për

Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të fillojë më 15 shtator dhe të përfundojë më 1 nëntor 2008.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1250, datë 10.9.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT “LIDHJA E QYTETIT BERAT-PËRMET”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i objektit “Lidhja e qytetit Berat-Përmët”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme të shpronësohet, për sipërfaqen 150 (njëqind e pesëdhjetë) m², tokë truall, e vlerësuar me 1 831 (një mijë e tetëqind e tridhjetë e një) lekë/m², për sipërfaqen 200 (dyqind) m², tokë arë, e vlerësuar me 851 (tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë/m², për objekt, me vlerë 2 193 973 (dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, dhe dru frutorë, vlerësuar me 77 500 (shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 716 323 (dy milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet e tre) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 550 000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 2 716 323 (dy milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet e tre) lekë, të përballohet nga buxheti shtesë i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të fillojë më 15 shtator dhe të përfundojë më 1 nëntor 2008.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE TË CILAT DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË OBJEKTIT LIDHJA E QYTETIT BERAT-PËRMET

Emri	Sip.	Çmimi/m ²	Sip	Çmimi/m ²	Objekt	Drufrutorë	Shuma
------	------	----------------------	-----	----------------------	--------	------------	-------

Mbiemri	truall	truall	are	are	Vlera në lekë	Vlera/lekë	totale
Petrit Dobroniku	150 m ²	1831 lekë/m ²	200 m ²	851 lekë/m ²	2 193 973	77 500	2 716 323

Vlera totale e shpronësimit është 2 716 323 (dy milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet e tre) lekë

VENDIM
Nr.1251, datë 10.9.2008

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT REFERUES TË TË PUNËSUARVE, PËR EFEKT TË PAGIMIT TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE, SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, NË DISA VEPRIMTARI KRYESORE, PËR TATIMPAGUESIT E REGJISTRUAR NË BIZNESIN E VOGËL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kur administrata tatimore vëren se numri i të punësuarve, të deklaruar nga tatimpaguesit e regjistruar në biznesin e vogël, për efekt të pagimit të kontributit të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, nuk është real dhe nuk i përgjigjet vlerës së tregut për shërbimet e punësimit, ajo ka autoritetin të bëjë rivlerësim, sipas llojit të veprimtarive dhe vëllimit të të ardhurave vjetore. Numri minimal referues i të punësuarve, përfshirë edhe të vetëpunësuarit, jepet në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Subjektet e regjistruara në biznesin e vogël janë të detyruara të deklarojnë, në organet tatimore, të gjithë personat, që punojnë në biznesin e tyre, përfshirë veten dhe anëtarët e paguar të familjes, me të cilët punon e bashkëjeton ligjërisht, si dhe të llogarisin e paguajnë kontributet, sipas përcaktimeve të akteve, ligjore e nënligjore, në fuqi.

3. Punonjësit e autorizuar të administratës tatimore, gjatë kryerjes së verifikimeve apo kontrolleve, shqyrtojnë numrin e punonjësve të deklaruar nga subjekti, si dhe kryejnë rivlerësimet e nevojshme, në bazë të llojit të veprimtarisë, vëllimit të punës, vendeve të punës e regjimit të punës, etj. në raport me numrin referues të punonjësve, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

4. Në rast kundërshtimi ndaj vlerësimeve të administratës tatimore, subjekti duhet të provojë se vlerësimi është i gabuar, të argumentojë e vërtetojë saktësinë e deklarimeve të bëra nga ana e tij, si dhe të ndjekë procedurat e ankimimit. Në këto raste, ministri i Financave autorizohet të përcaktojë procedurën administrative të shqyrtimit të ankesave, dhe mënyrën e dhënies së përgjigjes. Në rast të kundërshtimeve, subjekti ka të drejtë të ndjekë procedurën e ankimimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

5. Subjektet, që kryejnë më shumë se një veprimtari ekonomike, për efekte të zbatimit të këtij vendimi, klasifikohen sipas veprimtarisë kryesore. Veprimtaria kryesore ekonomike përcaktohet në bazë të përqindjes më të madhe të xhiros, të deklaruar nga subjekti dhe të saktësuar nga organet tatimore, bazuar në kriteret e përcaktuara në “Nomenklatura e veprimtarive ekonomike”, botim i Institutit të Statistikës. Në përcaktimin e numrit të punonjësve mbahen parasysh edhe lloji i veprimtarive, që zhvillohen.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela e numrit minimal referues të të punësuarve, përfshirë edhe të vetëpunësuarit, për disa veprimtari të subjekteve të biznesit të vogël, sipas nivelit të të ardhurave bruto vjetore për bazën e taksës

		Të punësuar gjithsej sipas nivelit të të ardhurave bruto vjetor për bazën e taksës (në mijë lekë)			
		+	+	+	+
Nr	Lloji i veprimtarisë	2.000-3.000	3.000-5.000	5.000-7.000	7.000-8.000
		3 000	5 000	7 000	8 000
1	Hotele	3	4	5	5
2	Motele	2	3	4	5
3	Hotel-restorant/Motel-restorant	5	5	6	6
4	Bar-Restorant	3	4	5	5
5	Restorant	3	3	4	5
6	Bar-kafe	2	2	3	4
7	Bar kafe-lojëra, internet etj.	3	3	4	5
8	Minimarkete	2	2	3	4
9	Prodhime brumi	2	3	4	5
10	Prodhime buke	2	3	4	4
11	Prodhime brumi dhe tregtim	3	4	4	5
12	Prodhime pasticerie	1	2	2	3
13	Hamburger-doner-etj.	2	2	3	4
14	Hamburger, doner, akullore	2	2	3	5
15	Piceri	2	2	3	4
16	Piceri, doner, hamburger, akullore etj.	2	3	3	4
17	Birrari-qebaptore	2	2	3	4
18	Punime duralumini	3	3	4	5
19	Punime karpentierie	3	3	4	5
20	Hekurkthyes, prodhim, montim kangjella etj.	3	3	4	5
21	Punime suvatimi + lyerje	3	3	4	5
22	Punime të ndryshme ndërtimi (riparime ndërtimi, hidro, elektrike etj.)	3	3	4	5
23	Reparte riparimesh, aparate elektrike, elektronike	2	2	3	4
24	Punime druri e mobilje	3	4	4	5
25	Punime dekor, reklama	2	3	3	4
26	Punime tapicerie	3	3	4	5
27	Autoservise	2	3	4	5
28	Autoservis + shitje pjesë ndërrimi	3	3	4	5
29	Çmontim makina dhe shitje p/ndërrimi të përdorura	2	3	4	4
30	Shkolla	-	5	6	7
31	Kopshte	2	3	5	7
32	Çerdhe	2	4	5	7
33	Kurse të ndryshme	2	3	4	5
34	Autoshkollë	4	4	5	5
35	Klinika mjekësore	3	3	4	5
36	Laborator analizash mjekësore	3	3	4	5
37	Klinika dentare	2	2	3	3
38	Klinika dentare + laboratore	3	4	5	5

39	Laboratore dentare	2	3	4	5
40	Qendra estetike, sallone bukurie	2	3	4	5
41	Qendra fitnesi, terapie, dietologjike etj.	3	3	3	4
42	Shtëpi botuese	2	2	3	4
43	Shtypshkronja	4	4	5	6
44	Shtypshkronja + aktivitet shitje	4	4	5	6
45	Studio projektimi	4	4	5	5
46	Studio arti, pikturë etj	3	3	3	4
47	Studio konsulence e ekspertize teknike, ligjore, financiare etj	4	4	4	5
48	Agjenci shërbimesh të ndryshme	1	1	2	3
49	Agjenci shërbimesh funerali	4	5	5	6
50	Prodhime material ndërtimi	3	4	4	5
51	Prodhime korniza, riparime	2	2	3	4
52	Prodhime kozmetike	2	3	4	4
53	Prodhime të pijeve freskuese	2	3	4	5
54	Prodhime mermeri	3	3	4	5
55	Lavazhe	2	3	4	5
56	Transport udhëtarësh me autobus	2	2	2	2
57	Transport udhëtarësh me furgon	1	1	2	2
58	Transport udhëtarësh me taksì	1	1	1	1
59	Transport mallrash	2	2	3	3

VENDIM
Nr.1252, datë 10.9.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ZHVILLIMIT TË TENDERIT PUBLIK, PËR
DHËNIEN E SË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pikat 1 e 3, dhe 69 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënie e së drejtës së përdorimit të frekuencave, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Autoriteti i Komunikimeve, Elektronike dhe Postare, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLAT E ZHVILLIMIT
TË TENDERIT PUBLIK PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE

KREU I ORGANIZIMI I TENDERIT PUBLIK

1. Parime të përgjithshme

1.1 Kur Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në referencë të nenit 68 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se kërkesat për caktim të frekuencave në një brez janë më të mëdha se frekuencat disponibël për t’u caktuar në këtë brez, atëherë për dhënien e së drejtës për përdorimin e këtij brezi frekuencash do të zbatohet procedura e tenderit publik.

1.2 Procedurat e tenderit publik do të zhvillohen në përputhje me këto rregulla, legjislacionin në fuqi për prokurimet publike dhe ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

1.3 AKEP mban procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të tenderit, në mënyrë që të lejojë kontrollin e zbatimit të legjislacionit.

1.4 AKEP mban dhe administron dokumentacionin e tenderit publik sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për arkivat.

2. Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave të tenderit publik

2.1 Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave të tenderit kryhet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

KREU II PROCEDURAT DHE DOKUMENTET E TENDERIT

1. Procedurat e tenderit publik

1.1 Procedurat e tenderit publik që zbaton AKEP për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave, sipas këtij vendimi janë:

- a) Procedurë e hapur;
- b) Procedurë me konkurrim.

1.2 “Procedurë e hapur” është procedura përmes së cilës çdo subjekt i interesuar, sipas këtij vendimi, mund të dorëzojë një ofertë gjatë zhvillimit të tenderit për dhënien nga AKEP të së drejtës për përdorimin e frekuencës/brezit të frekuencave, ku përzgjedhja e fituesit bëhet mbi bazën e vlerësimit të çmimit të ofertës dhe/ose kritereve teknike të vendosura për shfrytëzimin e tyre.

1.3 “Procedurë me konkurrim” është procedura përmes së cilës çdo subjekt i interesuar, sipas këtij vendimi, mund të dorëzojë një ofertë gjatë zhvillimit të tenderit për dhënien nga AKEP të së drejtës për përdorimin e frekuencës/brezit të frekuencave, ku përzgjedhja e fituesit bëhet mbi bazën e vlerësimit të ofertës sipas kritereve teknike të vendosura për shfrytëzimin e tyre.

1.4 Procedura e hapur është procedura e parapëlqyer për zhvillimin e tenderit publik. AKEP mund të propozojë procedurë me konkurrim vetëm në rastet kur kjo kushtëzohet nga veçoritë teknike të objektit të tenderit dhe përmbushjen e objektivave të politikës së zhvillimit të sektorit.

2. Përgatitja e dokumentit të tenderit

2.1 Në varësi të procedurës së miratuar, AKEP harton dhe miraton dokumentin e tenderit në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

2.2 Dokumenti i tenderit përfshin, por pa u kufizuar në:

- a) informacione të përgjithshme për:
 - kuadrin ligjor;
 - formularin e njoftimit;
 - udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
 - formularin e ofertës;
 - kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;
 - formularin e sigurimit të ofertës;
 - formularin e njoftimit të fituesit;
 - formularin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
 - formularin për botimin e fituesit;
- b) informacione specifike për:

- përcaktimin e frekuencës ose brezit të frekuencave;
- vlerën minimale të tregut të frekuencës ose brezit të frekuencave;
- autorizimin e përgjithshëm;
- autorizimin individual për përdorimin e frekuencave;
- njoftimin dhe regjistrimin;
- numeracionin;
- interkoneksionin dhe aksesin;
- informacion mbi tregun e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;
- informacion i përgjithshëm mbi Shqipërinë;
- pagesat etj.

2.3 Dokumenti i tenderit hartohet nga njësia e hartimit të dokumentacionit dhe miratohet nga Këshilli Drejtues i AKEP.

KREU III ZHVILLIMI I PROCEDURAVE

1. Njësia e hartimit të dokumenteve dhe urdhri për zhvillimin e tenderit

1.1 AKEP është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e procedurës së tenderit publik. AKEP duhet të sigurojë një ndarje të qartë të detyrave të personave të përfshirë në hartimin e dokumentit të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave. Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislationit në fuqi, duhet të mbahen parasysh përpara emërimit të një anëtar në njësinë e hartimit të dokumentacionit. Çdo person i përfshirë në procesin e zhvillimit të tenderit nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

1.2 Për zhvillimin e procedurës së tenderit publik, të miratuar nga ministri, Kryetari i Këshillit Drejtues/Drejtori Ekzekutiv i AKEP nxjerr Urdhrin për zhvillimin e tenderit, i cili duhet të përmbajë të paktën:

- a) objektin e tenderit;
- b) procedurën e miratuar nga ministri;
- c) përbërjen e njësisë së hartimit të dokumenteve.

1.3 Njësia e Hartimit të Dokumenteve është përgjegjëse për hartimin e dokumentit të tenderit, hartimin dhe dërgimin e njoftimeve brenda afateve të parashikuara nga ky vendim, mbledhjen dhe administrimin e dokumenteve të nevojshëm që kanë të bëjnë me tenderin, si dhe detyrat që i ngarkohen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

2. Njoftimi për tender publik

2.1 Përpara zhvillimit të tenderit, AKEP bën njoftimin publik për kryerjen e tij.

2.2 Njoftimi për tender botohet të paktën një herë në një gazetë me qarkullim ndërkombëtar, kur është e nevojshme, dhe dy herë në gazetën kombëtare, si dhe nëpërmjet letrave, faksit, postës elektronike etj.

2.3 Njoftimi publik shpallet edhe në faqen e internetit të AKEP.

3. Përmbajta e njoftimit për tender dhe e ftesës për ofertë

3.1 Njoftimi për tender duhet të përfshijë të gjitha informacionet, që u lejojnë kandidatëve të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e tenderit.

3.2 Në njoftimin për tender përcaktohen vendi, adresa dhe afati i fundit kohor, ku e kur do të dërgohen ofertat, si dhe gjuha ose gjuhët, në të cilat duhet të hartohen ofertat. Gjithashtu, përcaktohen edhe mënyra dhe kushtet për marrjen e dokumentit të tenderit.

3.3 Ftesa për ofertë përmban informacion por, pa u kufizuar, për:

- a) objektin e tenderit;
- b) kushtet, kërkesat kualifikuese të kandidatëve;
- c) vlerën minimale të tregut për frekuencën ose brezin e frekuencave;
- d) afatin përfundimtar dhe mënyrën e dërgimit të ofertave dhe dokumenteve që i bashkëlidhen;
- e) adresën, vendin, datën dhe kohën e hapjes publike të ofertave;
- f) personin e kontaktit për informacione shtesë;
- g) ndonjë informacion tjetër që AKEP e vlerëson të dobishëm.

4. Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve

4.1 Kandidatët ose ofertuesit, për të marrë pjesë në procedurën e tenderit për të fituar të drejtën e përdorimit të frekuencave (për marrjen e autorizimit individual), duhet të vërtetojnë se:

a) Janë shoqëri aksionere ose persona juridikë, të ngjashëm sipas legjislacionit të vendit ku ato janë krijuar, dhe janë të regjistruara tek autoritetet përgjegjëse ku ndodhet selia.

b) Mund të paraqesin oferta edhe bashkime investitorësh që veprojnë së bashku për qëllime të pjesëmarrjes në tender dhe që synojnë të kryejnë transaksionin nëpërmjet një shoqërie që do të krijohet.

c) Nuk janë në likuidim apo kanë aftësi pagueuse, nuk janë në administrim apo procedime të tjera të ngjashme, apo me ndonjë procedim, që nënkupton paafësi pagueuse apo ndërprerje biznesi,

d) Janë të padënuar, me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerje të njëres nga veprat:

- pjesëmarrje në organizata kriminale;
- korrupsion;
- mashtrim;
- pastrim parash.

e) Nuk kanë borxhe të pashlyera ndaj shtetit shqiptar.

f) Nuk janë në proces falimentimi.

4.2 Të gjitha kërkesat e pikës 4.1 të këtij kreu duhet të vërtetohen nëpërmjet certifikatave zyrtare nga autoritetet përkatëse ose me anë të dokumenteve të tjera zyrtare, të lëshuara jo më herët se 30 ditë përpara njoftimit për zhvillimin e tenderit. Nëse dokumentet e sipërpërmendura, për kandidatët ose ofertuesit e huaj, nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim nga kandidati ose ofertuesi.

4.3 AKEP, kur kërkohet informacion për kandidatin ose ofertuesin rezident në një shtet të huaj, mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve përkatëse.

4.4 Në rastin e dhënies në përdorim të brezave GSM për futjen në treg të operatorëve të rinj, do të vendoset kusht për përjashtimin nga pjesëmarrja në tender e të gjithë operatorëve të autorizuarve për përdorimin e këtyre brezave, si dhe ortakëve të tyre të çdo lloji.

4.5 Mosplotësimi i njërit prej këtyre kushteve përbën shkak për skualifikimin e kandidatit ose ofertuesit.

5. Kërkesa të përgjithshme për kualifikim

5.1 Ofertuesit e mundshëm për të marrë pjesë në procedurën e tenderit kualifikohen pasi të kenë përmbushur kriteret e mëposhtme, që AKEP i vlerëson të nevojshme për sa kohë që ato janë në pajtueshmëri me natyrën dhe përmasat e autorizimit individual që do të tenderohet dhe jo diskriminuese:

a) kualifikimi profesional

- Ofertuesit duhet të vërtetojnë se zotërojnë njohuri të përgjithshme në fushën e komunikimeve elektronike, në varësi të rastit (në varësi të frekuencës/brezit të frekuencave që tenderohet).

- Ofertuesit duhet të vërtetojnë se zotërojnë njohuri profesionale dhe eksperiencë mbi shfrytëzimin e frekuencave dhe teknologjitë që operojnë në atë brez, përkatësisht për brezin në objekt tenderimi.

b) afëlsitë teknike

- Ofertuesit duhet të paraqesin planin për shtrirjen dhe konfigurimin e rrjetit që do të ndërtohet dhe do të operojë në frekuencën/brezin e frekuencave që është objekt tenderimi.

- Ofertuesit duhet të paraqesin planin e tyre në lidhje me shërbimet, cilësinë e shërbimeve dhe/ose tarifat për shërbimet që do të ofrohen nëpërmjet rrjetit që do të operojë në frekuencën/brezin e frekuencave që është objekt tenderimi, në varësi të rastit.

- Ofertuesit duhet të garantojnë shfrytëzimin e frekuencave në përputhje me rekomandimet dhe standardet e ITU dhe CEPT.

c) gjendja ekonomike e financiare

- Ofertuesit vërtetojnë se zotërojnë kapacitete ekonomike e financiare për të përmbushur autorizimin individual, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet nëpërmjet bilanceve financiare ose pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme për një periudhë deri në tre vitet e fundit financiare.

d) kapacitetet ligjore

- Ofertuesit duhet të vërtetojnë se kanë zotësinë juridike për të përmbushur detyrimet e marrjes së autorizimit individual, ose në rastet e bashkimit të shoqërive vërtetojnë se i gëzojnë këto veti në kohën e marrjes së autorizimit individual.

5.2 AKEP është përgjegjës për përcaktimin e kërkesave të përgjithshme për kualifikim dhe kërkesat specifike në varësi të objektit të tenderimit (në varësi të frekuencës/brezit të frekuencave që do të jepet në përdorim). Në rastet e tenderave që kërkojnë njohuri të veçanta teknike apo juridike, AKEP, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të kontraktojë specialistë të jashtëm vendas ose të huaj, për të ndihmuar në hartimin e dokumenteve.

5.3 Kërkesat teknike dhe profesionale do të synojnë të garantojnë shfrytëzimin e frytshëm dhe efektiv të spektrit, si dhe përmbushjen e objektivave të zhvillimit të sektorit në raste të veçanta.

5.4 Dokumentacioni, në përmbushje të kërkesave të përgjithshme për kualifikim, do të paraqitet me shkrim dhe i shoqëruar me një deklaratë nga ofertuesi se, në rast se fiton të drejtën e përdorimit, do të respektojë përcaktimet në përgjigje të këtyre kërkesave. Deklarimet në përgjigje të kërkesave të përgjithshme për kualifikim mund të bëhen pjesë përbërëse e autorizimit nëse ofertuesi do të rezultojë i suksesshëm në marrjen e autorizimit.

6. Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit

6.1 Ofertuesi i mundshëm (sipërmarrësi) mund të kërkojë sqarime nga AKEP, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo sipërmarrës, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. AKEP duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga sipërmarrësi dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'u komunikojë sqarimin përkatës të gjithë kandidatëve të tjerë, që kanë tërhequr dokumentin e tenderit.

6.2 AKEP, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave të tenderit dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një kandidat, mund të bëjë ndryshime në dokumentin e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë kandidatëve blerës, që kanë tërhequr dokumentin e tenderit, dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. Në çdo rast, AKEP e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 5 ditë.

6.3 AKEP, gjatë takimit me kandidatët, duhet të mbajë procesverbal, ku përfshihen edhe kërkesat e dorëzuara gjatë takimit për sqarime për dokumentin e tenderit, si dhe përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, por, në çdo rast, pa identifikuar burimet e tyre.

7. Afatet kohore për dorëzimin e ofertave

7.1 AKEP, për përcaktimin e afateve kohore për dorëzimin e ofertave të tenderit, mban parasysh kompleksitetin e objektit të tenderit dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave, pa cenuar kufijtë kohorë minimalë, të përcaktuar në këtë dispozitë dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Afatet kohore në këtë vendim jepen në ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur ka specifikime të tjera.

7.2 Afati për paraqitjen e ofertave është jo më pak se 45 ditë nga data në të cilën është botuar njoftimi i tenderit.

8. Skualifikimi i ofertave

8.1 AKEP skualifikon në çdo kohë kandidatët ose ofertuesit, që paraqesin të dhëna të rreme ose një dokument të falsifikuar, për qëllime kualifikimi, gjatë një procedure tenderi.

8.2 AKEP skualifikon çdo kandidat apo ofertues, ndaj të cilit është marrë vendimi i përjashtimit nga procedurat e prokurimit publik dhe ankandi, sipas legjislacionit përkatës.

8.3 AKEP skualifikon çdo ofertues, oferta e të cilit është vlerësuar me më pak se 60 pikë.

Anullimi i tenderit

9.1 AKEP lejohet që, në çdo kohë, të anulojë tenderin, për arsye të interesit publik, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës. AKEP në asnjë rast nuk është i detyruar të shpallë fituesin për një tender.

9.2 AKEP nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve, që kanë paraqitur oferta, për vendimin e marrë në bazë të pikës 9.1 të këtij kreu.

9.3 AKEP, në përputhje me pikën 9.1 të këtij kreu, u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar tenderin, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit, dhe këtë njoftim e publikon në faqen e tij të internetit.

10. Paraqitja dhe pranimi i ofertave

10.1 Ofertuesit i paraqesin ofertat e tyre në përputhje me udhëzimet dhe kushtet e përcaktuara në dokumentin e tenderit.

10.2 Ofertuesit paraqesin vetëm një ofertë.

10.3 Oferta përfshin angazhimet e mëposhtme:

a) pranimin, prej ofertuesit, të kushteve të përcaktuara në njoftimin për tender;

b) pranimin, prej ofertuesit, të detyrimeve që rrjedhin nga fitimi i tenderit;

c) pranimin, prej ofertuesit, të kushteve të dokumentit të tenderit;

10.4 AKEP përcakton vendin, datën dhe orën e paraqitjes së ofertave.

10.5 Kur AKEP jep sqarime apo bën ndryshime në dokumentin e tenderit, vepron në përputhje me pikën 6 të këtij kreu.

10.6 Vendimi për shtyrje të afatit përfundimtar u njoftohet menjëherë të gjithë kandidatëve, që kanë tërhequr dokumentet.

10.7 Paraqitja e ofertave bëhet si më poshtë:

a) ofertat dorëzohen me shkrim, dorazi ose përmes postës, të nënshkruara dhe të mhyllura në zarf, sipas përcaktimeve të dokumentit të tenderit;

b) AKEP, sipas kërkesës, pajis ofertuesit me një dëshmi, ku shënohen data dhe ora e pranimit të ofertës.

10.8 Ofertat e paraqitura, pas mbarimit të afatit të fundit të paraqitjes së tyre, u kthehen të pahapura ofertuesve që i kanë paraqitur ato.

10.9 Të gjitha shpenzimet e kryera nga ofertuesit, për përgatitjen e ofertave të tyre, nuk rimbursohen.

11. Sigurimi i ofertës

11.1 AKEP u kërkon të gjithë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, e cila nuk mund të jetë më e madhe se 2-3 % e vlerës monetare minimale të tregut për frekuencën, të përcaktuar nga AKEP.

11.2 AKEP duhet të specifikojë në dokumentin e tenderit çdo kërkesë për natyrën, formën, vlerën dhe kushtet e tjera thelbësore të sigurimit të ofertës. Këto kërkesa nuk duhet të lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me sjelljen e kandidatit që dorëzon një ofertë, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) tërheqjes ose ndryshimit të ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentin e tenderit;

b) refuzimit për nënshkrimin e autorizimit individual, kur AKEP e kërkon një gjë të tillë;

c) mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të autorizimit individual të përcaktuar në dokumentin e tenderit.

11.3 AKEP nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe e kthen menjëherë mbrapsht atë, nëse:

a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës;

b) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

12. Vlefshmëria, modifikimi dhe tërheqja e ofertave

12.1 Një ofertë është e vlefshme nëse:

a) është marrë nga AKEP, në zyrat e tij në Tiranë, në datën dhe kohën e përcaktuar në dokumentin e tenderit;

b) ofertuesi plotëson kërkesat e njoftimit për tender;

c) ofertuesi jep garancitë e nevojshme;

d) ofertuesi nuk është skualifikuar sipas parashikimeve të këtij vendimi.

12.2 Ofertat janë të vlefshme gjatë periudhës kohore të specifikuar në dokumentin e tenderit.

12.3 AKEP, përpara përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertave, mund t'u kërkojë ofertuesve të zgjasin këtë periudhë për një afat të caktuar. Në këtë rast:

a) ofertuesi mund të refuzojë kërkesën, pa humbur sigurimin e ofertës dhe vlefshmëria e ofertës së tij përfundon me mbarimin e periudhës fillestare të vlefshmërisë;

b) kur ofertuesi pranon zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë, me të zgjatet edhe sigurimi i ofertës apo paraqitet një sigurim i ri oferte, që mbulon periudhën e zgjatur të vlefshmërisë. Ofertuesi, që nuk zgjat periudhën e sigurimit të ofertës, ose që nuk paraqet një sigurim të ri oferte, vlerësohet se e ka refuzuar kërkesën për zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

13. Ndalimi i modifikimit të ofertave

13.1 Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim për ofertën ndërmjet AKEP dhe ofertuesit, pa cenuar të drejtën e parashikuar në pikën 15.2 të këtij kreu.

13.2 AKEP nuk ka të drejtë t'u kërkojë ofertuesve të ndërmarrin përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, apo të ndryshojnë vlerën e ofertës ose ta modifikojnë në çfarëdo mënyre atë.

14. Hapja e ofertave

14.1 AKEP, për hapjen dhe shqyrtimin e ofertave, ngre Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), përbërja, të drejtat dhe detyrat e të cilit përcaktohen në këtë vendim.

14.2 KVO i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentin e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar, pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuar në dokumentin e tenderit.

14.3 Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, që kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave.

14.4 Emri, adresa e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, dokumentacioni ligjor dhe çdo dokument i kërkuar nga AKEP, si dhe çmimi i çdo oferte lexohen me zë të lartë për ata persona që janë të pranishëm dhe regjistrohen në procesverbalin e procedurës së tenderit.

14.5 Procesverbali duhet t'i vihet menjëherë në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesit që ka paraqitur ofertën, por që nuk është i pranishëm ose i përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'i dërgohet për njoftim.

14.6 Njësia e hartimit të dokumenteve është e pranishme gjatë hapjes dhe vlerësimit të ofertave, por anëtarët e saj nuk kanë të drejtë të votojnë ose të ndikojnë në procesin e shqyrtimit. Ata mund të japin mendime vetëm kur u kërkohet, si dhe kryejnë funksione të karakterit ndihmës.

15. Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

15.1 Pas hapjes dhe leximit të ofertave, siç parashikohet më lart, KVO, nëse gjykon se i nevojitet më shumë se një ditë pune për të përfunduar veprimtarinë e tij, vë në dijeni përfaqësuesit për orën dhe datën kur ofertuesve do t'u komunikohet rezultati i vlerësimit të ofertave. Kohëzgjatja e procedurës nuk duhet të kalojë 30 ditë.

15.2 KVO, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime me shkrim për ofertat e tyre për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

15.3 KVO, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 15.2 të këtij kreu, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. AKEP njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën dhe propozimet janë të vlefshme nëse pranohen nga ofertuesi.

15.4 KVO vlerëson se një ofertë është vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentin e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

15.5 KVO, në rastin e veprimeve të parashikuara nga pika 15.4 e këtij kreu, vlerëson se oferta është e vlefshme, nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e tenderit dhe në dokumentin e tenderit.

15.6 KVO nuk e pranon një ofertë:

a) kur ofertuesi nuk pranohet për shkaqe të përcaktuara në këtë vendim;
b) kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, të bërë sipas pikës 15.3 të këtij kreu;

c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentin e tenderit.

15.7 Vlerësimi i ofertave kryhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në këtë vendim. Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, KVO, bazuar në ofertat e pranuar, harton renditjen përfundimtare, e cila duhet të njoftohet në formën dhe në kohën e përcaktuar në dokumentin e tenderit.

15.8 Nëse dy ose më shumë oferta kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve.

15.9 Ofertuesit, brenda 5 (pesë) ditëve pune, pas marrjes së njoftimit të klasifikimit të

ofertave, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ pranë AKEP.

15.10 KVO, në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 15.9 të këtij kreu, dorëzon pranë AKEP raportin përmbledhës të tenderit. Ky raport përmban:

- a) objektin e tenderit;
- b) përmbledhje të procedurës së ndjekur;
- c) numrin e ofertave të paraqitura dhe një përmbledhje për çdo ofertë;
- d) kriteret e vlerësimit të ofertave dhe vlerësimin në bazë të këtyre kriterëve për secilën ofertë;
- e) renditjen e ofertuesve sipas vlerësimit të bërë nga komisioni;
- f) ankesat, nëse ka pasur.

15.11 AKEP, pas shqyrtimit të ankesave, nëse ka të tilla, i dërgon një njoftim ankimuesit lidhur me vendimin e marrë. Afati i shqyrtimit të ankesave është 5 (pesë) ditë pune nga marrja e saj.

16. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

16.1 KVO vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentin e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është parashikuar në këtë vendim, miratuar nga ministri dhe specifikuar në dokumentin e tenderit.

16.2 Në rastin e aplikimit të “Procedurës së hapur”, kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e fituesit janë:

- a) çmimi i ofertës; dhe/ose
- b) kërkesat teknike.

16.3 Në rastin e aplikimit të “Procedurës me konkurrim”, kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e fituesit janë:

- a) kërkesat teknike.

16.4 Kriteret e vlerësimit në secilën procedurë, do të përcaktohen me sistem pikëzimi. Numri maksimal i pikëve në një procedurë tenderimi do të jetë 100 pikë. Pikët për secilin kriter do të miratohen nga ministri njëherazi me miratimin e kriterëve dhe të procedurës, pas propozimit të AKEP, për çdo rast të tenderimit të frekuencave.

16.5 KVO, pas shqyrtimit të ofertave, shpall renditjen e ofertave të kualifikuara, duke filluar nga ofertuesi me numër më të lartë pikësh, në rend zbritës.

16.6 AKEP, shpall fitues ofertuesin, oferta e të cilit përmbush kriteret kualifikuese dhe ka grumbulluar numrin më të lartë të pikëve, por jo më pak se 60 pikë.

17. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

17.1 Komisioni i vlerësimit të ofertave - KVO caktohet nga AKEP dhe përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) persona, specialistë të fushës përkatëse të AKEP, përfaqësues të MPPTT dhe METE, kur është e nevojshme. KVO është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Në çdo rast numri i anëtarëve duhet të jetë tek. Personat përgjegjës për hartimin e dokumentit të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet mes zyrtarëve të lartë drejtues të AKEP dhe është plotësisht përgjegjës për organizimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Komisioni duhet të zbatojë detyrat e tij në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohet ndonjë sqarim në lidhje me dokumentin e tenderit, këto merren nga njësia për hartimin e dokumenteve. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër përveç atyre të përcaktuar shprehimisht në këtë vendim.

17.2 Nuk mund të marrin pjesë në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave personat që përbëjnë konflikt interesi me ofertuesit sipas kuptimit të ligjit “Për konfliktin e interesit”.

17.3 Çdo anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

17.4 Anëtarët e Komisionit dhe çdo person që ka marrë pjesë në procedurën e hartimit të dokumenteve kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertës.

18. Administrimi i informacionit në proces

18.1 Pas hapjes së ofertave, pa cenuar detyrimet e përcaktuara në këtë vendim, informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin e ofertave dhe rekomandimet për ofertën fituese nuk u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces, derisa të nënshkruhet autorizimi individual.

18.2 Pas hapjes së ofertave dhe deri në shpalljen e ofertës fituese, asnjë ofertues nuk ka të drejtë të komunikojë me AKEP ose të përpiqet, në çfarëdo mënyre, për të ndikuar në shqyrtimin

dhe vlerësimin e ofertave, përveç rasteve të parashikuara në këtë vendim.

19. Njoftimi i fituesit dhe dhënia e autorizimit

19.1 AKEP, pas miratimit të raportit përmbledhës, sipas pikës 15.10 të këtij kreu, dhe me mbarimin e afateve të procedurës ankimore, i dërgon një njoftim fituesit me shkresë zyrtare, si dhe e publikon njoftimin në faqen e tij të internetit.

19.2 AKEP dhe ofertuesi fitues nënshkruajnë autorizimin individual brenda 10 ditëve. Kjo periudhë nuk duhet të tejkalojë afatin e vlefshmërisë së ofertës, të përcaktuar në njoftimin e tenderit ose në dokumentet e tenderit.

19.3 Autorizimi individual hyn në fuqi kur nënshkruhet nga ofertuesi fitues dhe nga AKEP dhe pasi fituesi të këtë kryer pagesat e parashikuara në dokumentet e tenderit.

19.4 Kur ofertuesi fitues nuk arrin të nënshkruajë autorizimin individual, AKEP bën konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe përzgjedh ofertuesin e radhës në listën e ofertuesve që kanë mbetur, nëse diferenca e pikëve ndërmjet ofertës së ofertuesit fitues dhe asaj të klasifikuar menjëherë pas saj, është jo më e madhe se 10%. Kjo nuk cenon të drejtën e AKEP, sipas pikës 9 të këtij kreu, për të refuzuar të gjitha ofertat e mbetura dhe për të anuluar procedurën e tenderit. Njoftimi, sipas pikës 19.1 të këtij kreu, i dërgohet ofertuesit, oferta e të cilit është përzgjedhur sipas kësaj pike.

19.5 Autorizimi individual i nënshkruar para përfundimit të afatit të njoftimit të fituesit apo para përfundimit të shqyrtimit administrativ, sipas kreut IV të këtij vendimi, është absolutisht i pavlefshëm.

20. Kushtet për zbatimin e autorizimit individual

20.1 AKEP, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e autorizimit individual, për atë kohë sa ato janë të ligjshme dhe të përfshira në njoftimin e tenderit ose në dokumentin e tenderit.

20.2 Kushtet që rregullojnë zbatimin e autorizimit individual, duhet të kenë natyrë jodiskriminuese dhe të jenë në përputhje me objektin e tenderit.

21. Mungesa e konkurrencës

21.1 Për të vazhduar procesin e përzgjedhjes së fituesit në vijim të procedurës së tenderit duhet që numri i ofertave të vlefshme të jetë më i madh se numri i të drejtave të përdorimit të frekuencave që tenderohen, në të kundërt ndërpritet procedura dhe fillon një procedurë e re.

21.2 AKEP, përpara fillimit të procedurës së re, sipas parashikimit të pikës 21.1 të këtij kreu, analizon shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës së parë dhe i korrigjon ato, me qëllim që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës.

KREU IV PROCEDURAT E RISHIKIMIT ADMINISTRATIV

1. Procedura e ankimit

1.1 Shqyrtimi i ankesave të palëve që kanë interes në një procedurë tenderi publik dhe kur janë dëmtuar ose rrezikohen të dëmtohen nga një vendim i AKEP, që bie në kundërshtim me ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe këtë vendim, kryhet fillimisht nga AKEP dhe më pas nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të tenderit, kur gjykon se një vendim i AKEP është marrë në kundërshtim me këtë vendim.

1.2 Ankesa paraqitet pranë Këshillit Drejtues të AKEP brenda 5 ditëve pune nga data kur ankuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij vendimi.

1.3 Me marrjen e ankesës me shkrim, AKEP pezullon vazhdimin e procedurës së tenderit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 1.4 të këtij kreu.

1.4 Këshilli Drejtues i AKEP shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 5 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

1.5 Nëse Këshilli Drejtues i AKEP nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 1.4 të këtij kreu, ose e rrëzon atë, ankuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim pranë Ministrit të MPPTT, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankesës në AKEP.

1.6 Ministri, me marrjen e ankimit, pezullon procedurën deri në përfundimin e shqyrtimit të ankimit.

1.7 Ministri, brenda 20 ditëve pas marrjes së ankimit, duhet të bëjë shqyrtimin e ankimit.

1.8 Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, ministri, kur e gjykon se një vendim apo veprim i AKEP ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij vendimi, ka të drejtë:

a) të anulojë plotësisht ose pjesërisht një vendim apo veprim të AKEP të nxjerrë në kundërshtim me këtë vendim;

b) të udhëzojë AKEP të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e tenderimit;

c) të urdhërojë anulimin e procedurës për shpalljen e fituesit.

KREU V DISPOZITA TE VEÇANTA

1. Pagesat

1.1 Ofertuesi fitues do të marrë autorizimin individual vetëm pasi të ketë kryer pagesat e parashikuara sipas ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

1.2 Çmimi i ofertës, i ofruar nga ofertuesi që ka fituar të drejtën e përdorimit të frekuencës/brezit të frekuencave të tenderuar, derdhet prej tij në Buxhetin e Shtetit. Koha e kryerjes së kësaj pagese do të përcaktohet në dokumentin e tenderit, sipas rastit.

VENDIM Nr.1253, datë 2.7.2008

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT PËR DËMSHPËRBLIMIN E PËRFITUAR NGA ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 34 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Enti Kombëtar i Banesave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në bashkëpunim, kanë bërë përllogaritjet e masës së dëmshpërblimit financiar, si më poshtë vijon:

A) Në rastin e përfitimit pasuror, në të holla dhe letra me vlerë

1. Çdo kërkues, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për shqyrtimin në themel të kërkesës së tij nga Ministria e Drejtësisë, plotëson formularin e vetëdeklarimit për përfitimet, në të holla ose letra me vlerë, të marra prej tij me ligje të mëparshme.

2. Formulari i vetëdeklarimit është sipas modelit të përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Ai i dërgohet kërkuesit nga Ministria e Drejtësisë, së bashku me njoftimin për shqyrtimin në themel të kërkesës.

3. Ministri i Drejtësisë, pas mbërritjes së formularit të plotësuar nga ish-i dënuari politik ose i afërmi i tij, i dërgon Ministrisë së Financave një kopje të formularit të plotësuar dhe i kërkon të verifikojë përfitimet, në të holla dhe letra me vlerë, të ish-të dënuarit politik nga ligjet e mëparshme.

4. Ministria e Financave, pasi verifikon përputhjen e formularit të vetëdeklarimit me të dhënat e ish-Bankës së Kursimeve (aktualisht Raiffeisen Bank), i dërgon Ministrisë së Drejtësisë përgjigjen zyrtarë për masën e zbritshme të dëmshpërblimit, brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës. Përgjigjja formulohet sipas tekstit në vijim:

“Pas verifikimit dhe përllogaritjeve të kryera nga institucioni ynë, ju

informojmë se masa e zbritshme është_____ lekë, si përfitim i marrë nga ligje të mëparshme, nga ish- i dënuari politik z/znj_____.”.

ose

“Pas verifikimit të kryer nga institucioni ynë, ju informojmë se masa e zbritshme është_____ lekë, si përfitim i marrë nga ligje të mëparshme, nga ish- i dënuari politik z/znj_____ . Kjo shumë është e barabartë me shumën e deklaruar nga vetë kërkuesi, sepse të ne nuk ka të dhëna. “.

B) Në rastin e përfitimit pasuror, në formën e pasurive të paluajtshme

1. Çdo kërkues, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për shqyrtimin në themel të kërkesës së tij nga Ministria e Drejtësisë, plotëson formularin e vetëdeklarimit për përfitimet, në pasuri të paluajtshme, të marra prej tij me ligje të mëparshme.

2. Formulari i vetëdeklarimit është sipas modelit të përcaktuar në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Ai i dërgohet kërkuesit nga Ministria e Drejtësisë, së bashku me njoftimin për shqyrtimin në themel të kërkesës.

3. Ministri i Drejtësisë, pas mbërritjes së formularit të plotësuar nga ish-i dënuari politik ose i afërmi i tij, u dërgon Entit Kombëtar të Banesave dhe Zyres Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nga një kopje të formularit të plotësuar dhe u kërkon të verifikojnë përfitimet në pasuri të paluajtshme nga ish-të dënuarit politikë me ligjet e mëparshme.

4. Enti Kombëtar i Banesave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi verifikojnë, secila, përputhjen e formularit të vetëdeklarimit me të dhënat arkivore që kanë, i dërgojnë Ministrisë së Drejtësisë përgjigje zyrtare për masën e zbritshme të përfitimit.

5. Enti Kombëtar i Banesave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, i japin përgjigje, sipas tekstit në vijim:

“Pas verifikimit dhe përlllogaritjeve të kryera nga institucioni ynë, ju informojmë se masa e zbritshme është_____ lekë, si përfitim i marrë nga ligje të mëparshme.”.

ose

“Pas verifikimit të kryer nga institucioni ynë, ju informojmë se masa e zbritshme është_____ lekë, si përfitim i marrë nga ligje të mëparshme, nga ish- i dënuari politik z/znj_____. Kjo shumë është e barabartë me shumën e deklaruar nga vetë kërkuesi, sepse te ne nuk ka të dhëna.”.

II. Paraqitja në Ministrinë e Drejtësisë e formularëve të vetëdeklarimit nga ish-të dënuarit politikë apo të afërmit e tyre kryhet, brenda territorit të vendit, vetëm me anë të Postës Shqiptare, sh.a. Për kërkuesit me vendndodhje jashtë vendit, dorëzimi i këtij formulari kryhet nëpërmjet shërbimit konsullor përkatës. Punonjësi përgjegjës e përfshin këtë formular në dosjen individuale përkatëse.

III. Pas marrjes së përgjigjes nga Ministria e Financave, Enti Kombëtar i Banesave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Drejtësisë bën zbritjen e masës së përcaktuar prej tyre nga shuma e dëmshpërblimit, e përlllogaritur sipas nenit 6 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, dhe pasi harton listën emërore të përfituesve dhe përcakton masën e dëmshpërblimit përfundimtar për secilin, e paraqet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave.

IV. Ritrajtimi i kërkesave, të shqyrtuara para këtij vendimi

1. Për kërkesat e paraqitura në përputhje me pikat 1, të shkronjave “A” e “B” të këtij vendimi, për të cilat ka përfunduar shqyrtimi administrativ në datën e hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Ministria e Drejtësisë njofton menjëherë kërkuesin për plotësimin dhe dërgimin e formularëve të vetëdeklarimit, duke i dërguar edhe kopje të tyre. Në këto raste, kërkuesi dërgon, në mënyrën e përcaktuar në pikën II, formularët e plotësuar, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga Ministria e Drejtësisë.

2. Pas mbërritjes së formularëve të plotësuar, Ministri i Drejtësisë, u kërkon Ministrisë së Financave, Entit Kombëtar të Banesave dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

verifikimin e menjëherëshëm dhe pëllogaritjen e masës së dëmshpërblimit, që ish-të dënuarit politikë kanë përfitur me ligjet e mëparshme. Këto institucione, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, japin përgjigje zyrtare, sipas teksteve të përcaktuara në këtë vendim.

V. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Financave, drejtori i Entit Kombëtar të Banesave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1
FORMULAR VETËDEKLARIMI
“Mbi përfitimet në të holla dhe letra me vlerë”

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Mbiemri, emri	
Atësia, amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	
Mbiemri, emri i ish-të dënuarit politik	
Numri dhe data e dosjes individuale	
Libreza e depozitimit të letrave me vlerë (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se:

☐ kam/kemi përfitur dëmshpërblim në të holla në shumën _____ lekë; (Shuma në numra dhe fjalë)

☐ kam/kemi përfitur dëmshpërblim në letra me vlerë në shumën _____ lekë; (Shuma në numra dhe fjalë)

☐ nuk kam/kemi përfitur dëmshpërblim as në të holla dhe as në lekë.

DEKLARUESI

Emër, mbiemër / nënshkrim

Autorizim. Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga Ministria e Financave.

Nënshkrimi i deklaruës

Vendi dhe data e nënshkrimit

Shënim. Trajtimi të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

ANEKSI 2
FORMULAR VETËDEKLARIMI

“Mbi përfitimet në pasuri të paluajtshme”

Të dhënat e vetëdeklaruës:

Mbiemri, emri	
Atësia, amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	
Mbiemri, emri i ish-të dënuarit politik	
Numri dhe data e dosjes individuale	
Titulli i pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se:

☐ kam/kemi përfituar dëmshpërblim për dënimin e padrejtë politik banesë/apartament / lokal/tokë, në vlerën _____ lekë të reja në kohën e përfitimi.
(Shuma në numra dhe fjalë)

☐ nuk kam/kemi përfituar dëmshpërblim as në të holla dhe as në lekë.

DEKLARUESI

Emër, mbiemër / nënshkrim

Autorizim. Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Nënshkrimi i deklaruës

Vendi dhe data e nënshkrimit

Shënim. Trajtimi të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

VENDIM
Nr.1264, datë 17.9.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË FUSHË-KRUJË, TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Fushë-Krujë, të qarkut të Durrësit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 142 (njëqind e dyzet e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 962 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Fushë-Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Fushë-Krujë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
11	Momente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
12-150,152-188	Troje dhe hapësira	Në përdorim
189-193	Varrezat publike	Në pronësi
194-225,365-377,379-422,424-609,611-629,631-676,678-772,774-788,790-872,876-888	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
228	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
309-314, 315, 318-326	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë produktive)	Në përdorim
316,317,327,328,342,346, 352,356,361,962	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (kanale të treta, tokë inproduktive dhe objekte të ish-NB)	Në pronësi
226	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile	Në pronësi
151,392,329,330,313	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi

VENDIM
Nr.1265, datë 17.9.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,

SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS ZAGORIE, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Zagorie, të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Zagorie, të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.636, datë 29.9.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Zagorie, të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Zagorie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Zagorie		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-15	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
25	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
17	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
18-23	Verrezat publike	Në pronësi
41-69	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
258-335	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
221-223,225,227,228, 230,232,234,235,237,239, 240,242	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
224,226,229,231,233,236, 238,241,243,248,252,257	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 23.9.2008
Doli nga shtypi më 23.9.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë